

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

Përshëndetje!

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Garancia sovrane, e miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe që po diskutohet në seancën e stome, synon të mbështesë marrjen e borxheve apo të kredive nga subjektet e tregtimit me shumicë të produkteve ushqimore bazë, që këto të fundit të kenë mundësi të depozitojnë një sasi rezervash për një periudhë së paku 3-mujore. Ndërkohë që mbështesim marrjen e borxheve për produktet e shportës, për miellin, për orizin, për makaronat, si dhe për produkte të tjera të ngjashme me këto, në fakt asnjë qindarkë dhe asnjë politikë konkrete nuk ka për të synuar uljen e kostos së prodhimit në vend, të drithërave.

Aktualisht jemi në sezonin e korrjes së drithërave dhe nafta shënoi, jo më larg se dje, vlerën rekord prej 258 lekë për litër. A janë subvencionuar fermerët me naftë dhe sa prej tyre e kanë marrë naftën e premtuar dhe që u takon me të drejtë? Ministrja u krenua, duke thënë që këtë vit kanë aplikuar 49 mijë fermerë, në fakt, kjo është një arritje shumë e madhe. Në fakt, arritja më e madhe do të ishte që këta 49 mijë fermerë të ishin subvencionuar, mbështetur dhe ndihmuar, pasi kjo gjë do t'u shërbente jo vetë fermerëve në vetvete për të rritur të ardhurat e tyre, por në radhë të parë do t'i shërbente vendit, që ne sot të mos ishim përpara kësaj krize të papërgatitur dhe me një nivel shumë të ulët të prodhimit të drithërave në vend.

Fermerët nuk e kanë marrë naftën e premtuar dhe nuk e di se kur do ta marrin të gjithë fermerët këtë naftë, përveç atyre që dalin në foto dhe bëjnë propagandë në krah të ministres. Sot, ju vazhdoni të njëjtin avaz të vjetër për fermerët, veçse në një sezon të ri. Pra, traktori,

autokombajna dhe makineritë e tjera, të cilat duhet të jenë në kulmin e punës së tyre, pasi është sezoni, vazhdojnë të punojnë me naftë 258 lekë/litri. Kjo naftë është duke u shpërndarë në fotot që nxjerr ministria me ritmin e breshkës, ashtu siç jua citova, por se kur do të jepet nuk e dimë ende, jemi në pritje.

Unë mendoj që moment më kritik për fermerët shqiptarë sesa ky që po kalojmë nuk do të ketë. Nga ana tjetër fermerët sorollaten edhe nga burokracitë. Megjithëse i kanë pronat të certifikuara, u thuhet se nuk u dalin në sistem dhe sërish duhet t'u drejtohen zyrave të shtetit. Fermeri shqiptar përballet vetëm me burokraci dhe sot i ka sytë nga qielli dhe nga ju për të marrë atë që i takon, për t'i shërbyer në radhë të parë këtij vendi, përveç vetes dhe ekonomisë së tij. Ministria sapo tha që ne nuk mund të krahasohemi me asnjë vend të rajonit, por veçse me veten tonë. Ministria u shpreh se, nëse para 5 vjetësh kishin vetëm 4 apo 5 aplikantë, këtë vit kemi 49 dhe kjo është arritja jonë.

Në fakt, neve na intereson ekonomia shqiptare dhe ekonomia e fermerit, ekonomia e tij familjare dhe e vendit në mënyrë që shqiptarët sot të mos ndodhen para çmimeve stratosferike që kanë vetëm tendencë rritjeje, të drithërave, të bazës, të bukës, jam duke folur për bukën në çdo familje të thjeshtë shqiptare. Çdo herë në këtë foltore kam deklaruar se nuk mund të vazhdojmë me absurdin e trajtimit të fermerit njësoj si çdo qytetar, kur flitet sidomos për karburantin. Pra, nëse duam të nxitim prodhimin bujqësor, duhet të ulim koston, por kostoja fillon me karburantin, me pompën dhe të gjitha makineritë bujqësore që duhet të vihen në punë. Nafta për fermerin, sikurse në çdo vend të rajonit, duhet të jetë e zhveshur nga çdo lloj takse dhe të jepet jo vetëm para fushatave elektorale, por gjatë gjithë vitit, sidomos në pikun e sezoneve.

Plehrat kimike sot janë në qiell, farërat, fidanët, punimet e tokës, duke çuar në finale një kosto prodhimi tejet të lartë për fermerin shqiptar, kuptohet dhe me pak interes për të kultivuar produktet bazike, ato që na sigurojnë ushqimin e përditshëm. Ju ftoj te shkoni sot në Divjakë për të verifikuar se, edhe pse jemi në fillim të sezonit të shitjeve, çmimi i patates dhe i produkteve të tjera janë në vlera aq sa nuk mbulojnë dot as kostot dhe shpenzimet e prodhimit.

Ky është realiteti, ai që unë prek çdo ditë! Për drithërat ka humbur totalisht interesi për t'i kultivuar, për shkak të kostos së lartë dhe të çmimit, i cili deri dje ishte i papërfillshëm në treg.

Ministrja e Bujqësisë u shpreh: “Ne kemi rritur me 30% kultivimin e misrit dhe kemi ruajtur disa nivele të kultivimit të grurit. Unë jam nga ato që jetoj në fshat çdo ditë dhe kjo nuk më ka rezultuar, por më rezulton që tokat po mbillen gjithnjë e më pak me drithë dhe se fermeri nuk ka interes për kultivimin e drithit, kjo për shkak të politikave tuaja. Garancia sovrane patjetër që duhet të mbrojë bizneset, por garancia sovrane i shërben biznesit dhe aspak qytetarëve, të cilët përballen çdo ditë me çmimet në rritje të produkteve bazë ushqimore. Masat e zgjedhura nga qeveria shqiptare janë ato të kontrollit diktatorial nga ana e shtetit mbi tregun e lirë.

Qeveria duhet të rimbursojë, të mbështesë dhe të kompensojë nëpunësit, mësuesit, punëtorët, fermerët për çdo shtrenjtim të çmimeve dhe pamundësi të përballimit të situatës, duke ofruar paketa reale sociale dhe këto jo vetëm për pensionistët e vetmuar dhe invalidët, por për çdo punonjës të ndershëm të këtij vendi me paga modeste. Inflacioni për prillin ishte 6,2%, akoma më i lartë ai për majin. Megjithëse ministrja konfirmon një ulje, është norma më e lartë e inflacionit në 20 vjet nga viti 2001, kjo sipas INSTAT-it dhe të dhënave tuaja, rritja është ndikuar më së shumti nga grupimi “ushqime dhe pije alkoolike” me +3,56 pikë/përqindje, megjithëse nuk jam ekonomiste, e pasuar nga transporti, ku norma e inflacionit e rritur përbëhet kryesisht nga aktivitetet dhe gjërat më bazike që u duhen qytetarëve.

Ky shtrenjtim i jetesës rëndon në çdo xhep, prandaj mendoj se secili prej qytetarëve duhet të ndiej praninë e shtetit, të shtetit që mendon për ta dhe jo të shtetit që pasurohet në kohë krize prej tyre, sepse këta jeni ju. Ju keni zgjedhur të bëni këtë të dytën, të pasuroheni në kohë krize nëpërmjet çmimeve të rritura. Ju talleni dhe kënaqeni kur sodisni vështirësitë në rritje të këtij populli për jetesën e përditshme, pa dyshim, sepse kështu i gënjeni shumë më lehtë me thërrimet tuaja përpara fushatave elektorale. Faleminderit!